





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gjiçane Belediyesi

Në bazë të nenit 34 paragrafi 12 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 të Republikës së Kosovës ,nenit 18 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 dhe nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Gjiçanit bënë këtë :

SHPLLJE PUBLIKE

Për angazhimin e një (1) eksperti të jashtëm, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për pranim në procesin e përzgjedhjes /vlerësimit të burimeve njerëzor, nga organizata të specializuara në menaxhimin e burimeve njerëzore apo universitetet e fushës.

Kandidatët e interesuar për të qenë pjesë e angazhimit në cilësinë e anëtarit të komisionit të pranimit duhet plotësuar këto kriterë:

- Diplomë Universitare, në fushën e juridikut me të paktën 240 ECTS
- Së paku 4 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit në pozita të nivelit drejtues,
- Të mos ketë qenë 5 vitet e fundit anëtar të organeve drejtuese të një subjekti politik,
- Të mos jetë shërbyes civil dhe të mos jetë punëtor në administratën shtetërore
- Të mos ketë qenë i dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale.

Kandidati i interesuar për të qenë pjesë e komisionit duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim;

Një CV,

Kopjen e letër njoftimit,

Dëshminë për shkollimin e kryer në vend fotokopje e noterizuar, ndërsa jashtë vendit e nostrifikuar

Dëshminë për përvojën e punës,

Dëshminë që nuk është nën hetim apo i dënuar penalisht për ndonjë veprë të kryer penale,

Çdo dëshmi tjetër shtesë (p.sh. punime shkencore nga fusha e burimeve njerëzore) e cila është me rëndësi për kandidatin që aplikon

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues dhe ekspertit si anëtar janë të përcaktuara me nenin 34 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 të Republikës së Kosovës dhe nenin 21-24 të

Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Angazhimi i ekspertit të jashtëm është me mandat **dy (2) vjeçar** dhe nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së punës.

Eksperti për secilën procedurë të rekrutimit do të paguhet me pagesë fikse 250 € (dyqindepesëdhjetëeuro)

Aplikimi i kandidatëve të interesuar bëhet përmes Qendrës për Shërbim me Qytetar të Komunës së Gjilanit duke i dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas shpalljes në kopje fizike.

Afati i aplikimit; **8** kalendarike nga dita e publikimit të shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve publike gjegjësisht nga data **22.03.2022 deri me datë 29.03.2022.**

Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të arritura dhe vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e kërkuara për aplikim do të përzgjidhen në listën e ngushtë nga e cila listë do të përzgjidhet edhe kandidati më i suksesshëm.

Dokumentet e arritura pas afatit dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni